

Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me Platforma CiviKos, **hapin procesin e votimit për dy (2) anëtarë të Këshillit për Bashkëpunim Shoqëri Civile - Qeveri.**

Votimi do të jetë i hapur nga data 16 - 23 nëntor 2021, ora 17:00.

Kandidatët e nominuar janë:

Dorina Lluca Davies	Nominuar nga: YMCA Movement
Rinor Krasniqi	Nominuar nga: OJQ Jeta Rinore
Shemsije Seferi	Nominuar nga: Shoqata për Emancipimin e Femrës ALMA
Vlorian Molliqaj	Nominuar nga: Kosova Population foundation dhe Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime

Të gjitha OShC-të e regjistruara në Kosovë mund të votojnë për së paku një kandidat, ose më së shumti dy kandidatë të përfshirë në fletëvotim. Fletëvotimin mund ta shkarkoni këtu:

[http://www.civikos.net/repository/docs/Fletevotimi\\_2021\\_6452.pdf](http://www.civikos.net/repository/docs/Fletevotimi_2021_6452.pdf)

#### MËNYRAT E VOTIMIT

Votuesit mund të hedhin votën e tyre:

- Me e-mail: [info@civikos.net](mailto:info@civikos.net);
- Postë të rregullt (Adresa: Platforma CiviKos - Rr. Bedri Pejani 7/A, Prishtinë);
- Në kuti të votimit në zyrat e Platforma CiviKos, Rr. Bedri Pejani 7/A, Prishtinë).

Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së (votat pa dokumente mbështetëse nuk merren parasysh).

Sekretariati i Platforma CiviKos do të ndërmerr të gjitha masat që votat me email dhe postë të mbesin sekrete.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platforma CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i Platforma CiviKos. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni i Sekretariatit të Platforma CiviKos do të numërojë fletëvotimet.

Dy kandidatët që marrin më së shumti vota do të emërohen anëtarë të Këshillit.

Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShC-ve në Këshill do të përcaktohet me short në mes tyre.

#### NUMËRIMI I VOTAVE

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhgueseve të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve dhe përfaqësuesit e ZQM/ZKM.

#### TRANSPARENCA

Platforma CiviKos do të publikoj listën e të gjitha organizatave që kanë votuar.

**Të drejtë vote kanë të gjitha OShC-të e regjistruara në Kosovë, pavarësisht a janë anëtarë në Platforma CiviKos apo jo.**